
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Rrogozhinë, më ____ . ____ . 2022

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Sherbimi, Pastrimit, Gjelberimit, Varreza, Dekorit, ne territorin e Bashkise Rrogozhine, (per 5 Vite).

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 90522400-6 - Pastrimi dhe trajtimi i tokës

VLERA E FONDIT LIMIT:

305.040.650 (treqind e pese milion e dyzet mije e gjashtëqind e pesëdhjetë), leke pa TVSH.
(Kursi i këmbimit 116) euro

Burimi i financimit: Financimi për vitet buxhetore 2022 është në përputhje me vlerën e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2022” (i vlerësuar i ligjshëm nga Prefekti i Qarkut Tiranë) ndërsa financimi i vitet ne vazhdim do të realizohet sipas PBA.

Procedura e prokurimit do të jetë e llojit **Kontrate sherbimi me afat 5 Vjecar** mbështetur në nenin 41, paragrafi dyte dhe neni 42 të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe sipas nenin 46, pika 1 dhe pika 2 germa a), te VKM-se, nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti Kontraktor ka nevojë për shërbime të një natyre të përsëritur ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (objekti, sasi, specifikimet) duke qënë se ky shërbim është një shërbim me natyrë të përsëritur vit pas viti dhe për të realizuar shërbimin e pastrimit pa ndërprerje, duke eliminuar shtesa dhe amendamente të fillim vitit.

Eshtë gjykuar e arsyeshme aplikimi i kontratës shumëvjeçare, duke qenë se në rastin konkret kontrata shumëvjeçare garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e realizimit në kohë të shërbimit, si dhe qëndrueshmëri në kryerjen me cilësi të shërbimit.

Gjykohet e arsyeshme dhe e argumentuar se lidhja e një kontrate shumëvjeçare, rrit efikasitetin dhe shmang vonesat apo mos ofrimin në kohë të këtij shërbimi ndaj qytetarëve, të cilat mund të vijnë për shkaqe të ndryshme objektive që nuk varen nga autoriteti kontraktor, ndërkohe që domosdoshmëria për këtë shërbim është me rëndësi shumë të madhe për komunitetin, duke marrë në konsideratë faktin që ky shërbim përbën interes publik të rëndësishëm së veçantë, me karakter të përditshëm dhe të vazhdueshëm.

Kërkesat e autoritetit kontraktor Bashkia Rrogozhinë, janë realizimi i vazhdueshëm, eficient dhe me cilësi të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave (mbetjeje urbane).

Për këtë arsye, kërkesa e Bashkisë Rrogozhinë është që shërbimi i pastrimit të kryhet me mjete teknologjike bashkohore, me staf të specializuar dhe eficientë. Të gjitha këto kërkesa përkthehen në shërbime cilësore dhe mjedis sa më të pastër.

Kontratat shumëvjeçare krijojnë një raport më të mirë ndërmjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për shërbime cilësore dhe kostos që kanë operatorët ekonomikë për të ofruar këto shërbime me kapacitete optimale.

Në mbështetje të nenit 41 pika 1, germa a) dhe nenit 42 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 46 pika 1 dhe pika 2 germe a), të VKM- së nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, procedura do të jete e hapur mbi kufirin e larte monetar:

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Rrogozhinë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së përlllogaritur/ fondit limit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim, konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Rrogozhinë dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020, 2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar,

ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “ Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. “*në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe*

përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuaren” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 40% të vlerës së fondit limit, që është nën vlerën kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 40% të fondit limit.

3.3.14. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në tender licensën profesionale të shoqërisë, e vlefshme me kategorinë kodin III.1.A, të lëshuar nga organi përkatës QKL për pastrim, gjelbërim, funeral e mirëmbajtje varrezash.

Gjithashtu, kjo licensë duhet të jetë e shoqëruar detyrimisht me autorizim mjedisor për grumbullimin, pastrimin, transportin e mbetjeve urbane, gjelbërim, fshirjen e rrugëve, lëshuar nga Ministria e Mjedisit\institucioni kompetent.

3.3.16. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në tender licensën profesionale të shoqërisë, e vlefshme me kategorinë kodin III.2.B, të lëshuar nga organi Ministria e Mjedisit\institucioni kompetent për grumbullim, transportim të mbetjeve urbane

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme **3.3.14 dhe 3.3.16** është përcaktuar bazuar në pikën 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e

integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

3.3.2 Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë me përvojë pune të paktën 5 vjeçare në fushën e shërbimeve publike, në profilin mjedis/agromjedis, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë, për të gjithë periudhën e kërkuar. Deklarata e mësipërme duhet të jetë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: CV e drejtuesit teknik, Librezë pune, diplomë, si dhe kontratë pune të vlefshme.

Ky kriter për kualifikim, duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.3.11. Kandidati/ Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë të punësuar në shoqëri të paktën 1 person, të përfshirë edhe si drejtues teknikë, të diplomuar në biologji mjedisore, për të cilin duhet të paraqitet në tender kontrata e punës e vlefshme, diploma, librezë e punës, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit.

3.3.15. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë, për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, të paktën një punonjës të kualifikuar sipas formimit profesional për veglat e dorës manuale dhe ato me energji, sipas legjislacionit në fuqi.

Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit kontrata e punës e vlefshme dhe çertifikata/dokumenti i formimit profesional, i lëshuar nga institucione shtetërore/kompani të licensuara në fushën e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për kurset e formimit profesional.

Ky kriter për kualifikim, duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi

3.3.17. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të disponojë në stafin e tij, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, të paktën një person të çertifikuar për mjedisin dhe problemet mjedisore, si dhe për vlerësimet e ndikimit në mjedis, për të cilin duhet të paraqitet në tender kontrat e punës e vlefshme, si dhe dokumentacioni që provon kërkesën e mësipërme.

3.3.21. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë të punësuar në shoqëri të paktën 3 persona të pajisur me çertifikata të aftësisimit profesional për mjetet teknologjike, për të cilët të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmia profesionale, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërsëi për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit.

Ky kriter për kualifikim, duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3.3.23. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë pjesë të stafit të tij, i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë, për të gjithë periudhën e kërkuar në dokumentet e tenderit, të paktën një punonjës të kualifikuar sipas formimit profesional për rrezikun e menaxhimit e agjentëve kimikë, sipas legjislacionit në fuqi.

Për plotësimin e këtij kriteri për kualifikim, duhet të paraqitet në procedurën e prokurimit kontrata e punës e vlefshme dhe çertifikata/dokumenti i formimit profesional, i lëshuar nga institucione shtetërore/kompani të licensuara në fushën e formimit profesional, e njohur dhe miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për kurset e formimit profesional.

Ky kriter për kualifikim, duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV përkatëse të tij.

Kërkesa që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislacioni për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencen.

Kërkesa për një punonjës të licencuar si “Koordinator i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë” dhe një punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

3.3.3. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës së shërbimit të kërkuar.

Numri mesatar i punonjësve të siguruar, të kërkuar për periudhën Maj 2022 – Korrik 2022, duhet të jetë jo më pak se 50 punonjës. Për plotësimin e këtij kriteri duhet të paraqiten në tender:

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për çdo muaj, sipas legjislacionit në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar.

Gjithashtu, së bashku me vërtetimin e mësipërm, të paraqiten në tender edhe listëpagesat përkatëse E/Sig-25, për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për të gjithë periudhën e kërkuar, Maj 2022 – Korrik 2022, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter për numrin e punonjësve, plotësohet nëpërmjet vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse, por që duhet të administrohet edhe fizikisht nga Operatori Ekonomik Ofertues.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 50 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t’i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale,

personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

3.3.13. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë në tender vërtetim/dokumentacion nga Drejtoria Rajonale e Transportit/Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që shoqëria ofertuese nuk është debitore për taksat vjetore të mjeteve në pronësi, gjoba të kontrollit teknik apo gjoba të tjera për të gjitha mjetet që do të ofertojë.

3.3.29. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues duhet të disponojë, në pronësi ose me qira, minimalisht mjetet e mëposhtme, për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit, si më poshtë:

Automjet teknologjik, copë 2, për heqje dhe transport mbeturinash nga kontenerët, me kapacitet mbajtës 10 ton e sipër, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash.

Automjet teknologjik, copë 1, për heqje dhe transport mbeturinash nga kontenerët me kapacitet mbajtës 9 ton e sipër, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash.

Automjet teknologjik, copë 1, për heqje dhe transport mbeturinash nga kontenerët me kapacitet mbajtës 6 ton e sipër, me ngarkim fundor dhe me presim mbeturinash.

Autobot uji, copë 1, me kapacitet në aftësi mbajtëse në volum 9 m³ e sipër.

Kamionçinë, copë 1, me kapacitet mbajtës 3.5 ton e sipër.

Kontenier mbeturinash, 280 copë, që do të vendosen në vendet e përcaktuara nga Enti/Autoriteti Kontraktor, me kapacitet mbajtës në volum 1100 litra.

Të gjitha mjetet duhet të jene në pronësi ose me qira dhe të jenë të shënuara në regjistra publikë. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si dhe fotot ku të jenë të dukshme targat e mjeteve.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes, për ato mjete që janë marrë me qira këto dokumenta duhet të jenë bashkëlidhur kontratës së qirasë noteriale, e cila duhet të përfshijë të gjithë periudhën e kërkuar, si dhe të jetë përcaktuar objekti i këtij prokurimi. Në kontratat me qira duhet të specifikohet objekti i marrjes me qira, qëllimi dhe destinacioni i mjeteve, së bashku me dokumentacionin provues të tyre.

Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e

kërkuar, si dhe dhe për ato me qira përveç dokumentave të mësipërme, duhet të paraqitet kontrata e qirasë e vlefshme deri në afatin e përfundimit të kontratës së pastrimit.

Do të njihen vetëm mjetet e paraqitura në pronësi ose me kontratë noteriale qiraje, ose sipas Ligjit Shqiptar në fuqi.

Nuk lejohet dhe nuk do të pranohet blerja e mjeteve me kusht apo me kontrata paraprake blerje.

Çdo makineri duhet të jetë e shoqëruar detyrimisht me dokumentacionin e mësipërm të kërkuar.

Ky kriter për kualifikim, duhet të plotësohet sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zërat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetstim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimeve ligjore në Kodin Civil.

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

3.3.28. Kandidati/Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga organizma ndërkombëtare ose shoqëri të akredituara në Republikën e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme datën e hapjes së procedurës së prokurimit publik:

ISO 9001:2015 certifikatën e menaxhimit të cilësisë së punimeve; ose ekuivalente.

ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit mjedisor, ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 3.3.28 është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1 , neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe i sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri I mesiperm për paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

LOTI 2: “SHËRBIMI I PASTRIMIT TË TERRITORIT TË BASHKISË HIMARË, NJËSIA ADMINISTRATIVE HORË- VRANISHT DHE LUKOVË”

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit të lotit 2.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, afatin e kontrates dhe eksperiencat e mëparshme nga AK Bashkia Himare dhe Autoritete të tjera kontraktore kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlogaritur/ fondit limit të lotit 2.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019, 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nëneni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.4 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit "Shërbim konsulence", si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “ Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4. “*në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomike zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomike të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontrata e zbatuara në të shkuaren*” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën maksimale 30% të vlerës së fondit limit, që është nën vlerën kufi maksimale e përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 30% të fondit limit.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Liçencë të vlefshme të shoqërisë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) , Kategoria III.2 “ Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis “, Nënkatëgoria III.2.B “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme **2.3.2** është përcaktuar bazuar në piken 2, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “*Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë*” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr. 10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 “Per mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr

10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, pasi liçenca me (kodi III.2.B) është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike ku kërkohet pastrimi, grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për **objektin e marrëveshjes kuadër/kontratës**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë;
- b) CV përkatëse;
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Diplomë;
- b) CV-në përkatëse;
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

- 1 (një) punonjës të liçencuar si “Koordinator i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Liçencë;
- b) CV-në përkatëse;
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

- 1 (një) punonjës të liçencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave”, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- d) Liçencë;
- e) CV-në përkatëse;
- f) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë*

dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin...”, sjellim ne vemendje se:

- Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara fazës së nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (email zyrtar) ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Autoriteti kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimit e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij , është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vertetohen në CV përkatëse të tij.

Kërkesa që operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, 1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin, relacionet dhe raportet teknike, specifikimet dhe zërat e shërbimit që do të realizohen dhe do të monitorohen në vazhdimësi nga ky lloj inxhinieri. Nevoja për inxhinierin mjedisi në objekt është e diktuar nga përvoja e mëparshme, legjislativi për mjedisin rekomandimeve të APP dhe vendimeve të KPP në lidhje me këto kriter me arsyetimin për mos të ngushtuar konkurrencen.

Kërkesa për një punonjës të licencuar si “Koordinator i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë” dhe një punonjës të licencuar si “Ekspert Dhënie e Ndihmës së Parë dhe Ndërhyrjen ndaj Emergjencave” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët. Numri i stafit kryesor është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e e shërbimit. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht – 30 (tridhjetë) persona**, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022 vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022.
- b. Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022 shoqëruar me formularet e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqis punëtore prej **minimalisht –30 (tridhjetë)**, për periudhën Gusht 2021 - Janar 2022. Dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, do të paraqiten përpara se autoriteti kontraktor të vijojë me njoftimin përfundimtar të fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në grafikun dhe orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë totale punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e

tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 40 persona është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen shërbimeve si dhe VKM për kohën e punës në muaj për punonjës. Po t'i referohemi preventivit, VKM, relacionit, matjeve përkatëse që janë bërë i është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, **ku të përcaktohet tipi (emertimi teknik), lloji, marka, nr. i shasise, viti i prodhimit dhe sasi të përkatëse për mjetet si me mëposhte:**

- a) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 10 ton, jo më pak se **2 (dy) copë. (një rezervë)**
- b) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 8 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- c) Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më shumë se 5 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- d) Makinë vetëshkarkuese e hapura nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues jo më pak se 3.5 ton, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- e) Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtës jo më pak se 7-8 mije litra ujë, jo më pak se **1 (një) copë;**
- f) Makina me vinc për ngarkim-shkarkim kazanesh gjatë levizjes dhe sharkimit në vendet e përdorimit, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- g) Të paraqiten mjetet dhe pajisjet e mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë, jeleke për veshje të punësuarëve 20 cope dhe mushama shiu trupore 20 cope; .

Për mjetet e kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Për mjetet e deklaruara në pronësi që shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) ,leje qarkullimi , çertifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.

- Per mjetet e deklaruar me qera qe shënohen në regjistra publike duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale te qirasë, dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë), leje qarkullimi, certifikate e kontrollit teknik, siguracion mjeti.
- Kontrata e qerasë duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, të cilat deklarohen në pronësi, operatori ekonomik, duhet të paraqese kontratën e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes.
- Mjetet e porositura duhet të shoqërohen me Akt Marrëveshjen e porosisë/Kontratën e Porosisë (original ose kopje e noterizuar). Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të përmbajë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit te porositur(emertimin teknik),llojin,marken,nr. e shasisë,vitin e prodhimit, kushtet e kontratës si dhe afatin për ekzekutimin e porosisë. Akt Marrëveshja e porosisë/Kontrata e Porosisë duhet të shoqërohet dhe me katalogun e mjetit të porositur.
- Per mjetet e paregjistruara ne Republikën e Shqiperise, paraqitet marreveshje paraprake e shitblerje sipas njerit prej rasteve ne vijim,
 - (i) me pronarin e automjeteve.
 - (ii) me koncesionarin ose ndermjetesin ne rastin kur ka periudhe tranzitore per te pasur te drejten e posedimit te mjeteve.
 - (iii) me prodhuesin ose koncesionarin ne rastin e paraqitjes ne proceduren e prokurimit me mjete te reja.
 Ne te gjitha rastet subjekti duhet te paraqese dokumentacionin e nevojshem i cili verteton se subjekti qe merr persiper furnizimin e mjeteve ka sipas dokumentacionit te vendit te origjines, te drejten per te pasur ne pronesi ose gezuar te drejten e shitblerjes se mjeteve te paraqitura.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- Për mjetet në pronësi/qera apo të porositura, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku Autoriteti Kontraktor brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve nga Shpallja e Fituesit, rezervon të drejtën të kryejë verifikimin fizik të mjeteve sipas Specifikimeve Teknike të deklaruar në procedurën e prokurimit për të cilën është shpallur Fitues, si dhe të deklarojë adresën e sakte të vendndodhjes së mjeteve në Shqipëri, me qëllim verifikimin e tyre. Në rast se Operatori ekonomik i shpallur Fitues nuk i disponon mjetet brenda afatit të sipërcituar, ai do të s'kualifikohet, dhe Autoriteti Kontraktor do të kalojë tek Operatori ekonomik i kualifikuar, vijues në renditje.

2.3.5.1 Operatori ekonomik duhet të ketë liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): Kodi III.7.3.B.1.a.b.c.ç “Sherbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, autoriparimi i mjeteve për të siguruar një shërbim riparimi të mjeteve që do të meren me realizimin e kontratës së shërbimit të pastrimit, gjatë tërë periudhës së zbatimit të kontratës e në vecanti gjatë periudhës së verës, ose të ketë kontratë shërbimi me kohëzgjatje sa kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik të liçencuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Numri dhe lloji i makinerive dhe paisjeve është vendosur duke ju referuar zerave të shërbimit sipas specifikimeve teknike, sipas grafikut të detajuar dhe kohëzgjatjes së shërbimit, Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave. Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në zerat e shërbimit.

Nga ana e autoritetit kontaktor vendosja e këtij kriteri është në përpjetstim më natyrën, zërat e punimeve dhe vlerën e kontratës si dhe përcaktimeve ligjore në Kodin Civil.

Kërkesa për liçencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB): Kodi III.7.3.B.1.a.b.c.ç “Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor”, autoriparimi i mjeteve për të siguruar një shërbim riparimi të mjeteve që do të meren me realizimin e kontratës së shërbimit të pastrimit, gjate të tere periudhes së zbatimit të kontratës e në vecanti gjate periudhes së verës, ose të ketë kontratë shërbimi me kohëzgjatje sa kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik të liçencuar, është gjykuar e nevojshme nga ana e Autoritetit Kontraktor duke marrë shkas nga problematikat dhe vonesat që sjellin avaritë të mjeteve, sidomos gjatë sezonit. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesin çertifikata të lëshuara nga organe të pavarura të autorizuar/akredituara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Certificate: EN ISO 9001: 2015 Per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise ose ekuivalente ;
- EN ISO 14001:2015 Per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ose ekuivalente
- OHSAS 18001: 2007 Per Sistemin e Menaxhimit te Shendetit dhe sigurimit ne pune ose ekuivalente.

Çertifikimet e mësipërme duhet të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer e të noterizuara nëse janë në gjuhë të huaj, të jenë të vlefshme, si dhe duhet të plotësohen nga secili prej anëtarëve në rast të ofertës nga bashkim operatorësh, përveç çertifikimeve të cilat lidhen me procese të veçanta të cilat duhet të plotësohen në përputhje me zërat/proceset e marra përsipër në bashkëpunim

* Të gjitha çertifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.3 e 2.3.4 është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.” dhe pika 1 , neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimet dhe realizojnë objektin e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, të mjedisit dhe i sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit përgjegjës për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri I mesiperm per paraqitjen e certifikatave ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.
